



1 - Çfarë është diabeti?

“Diabeti melit” është një gjendje hiperglicemie kronike (nivele të larta të sheqerit në gjak) që çon në shfaqjen dhe zhvillimin e një sërë ndërlikimeve në periudhë afatgjatë. Nëse diabeti mbahet nën kontroll, mundëson një jetesë normale. Personat me diabet mund të punojnë, të luajnë sporte dhe mund të kenë fëmijë të shëndetshëm.


Çfarë është diabeti?



Diabeti është një sëmundje e karakterizuar nga nivele të larta të glukozës (sheqerit) në gjak (glicemia), për shkak të një defekti në sekretimin e insulinës, një hormon që prodhohet nga pankreasi, i cili ul nivelin e sheqerit në gjak.



Insulina mundëson transportin e glukozës nga gjaku në qelizë ku ajo transformohet në energji. Nëse insulina nuk prodhohet, nuk vepron si duhet apo prodhohet në sasi të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e një individi, nivelet e sheqerit në gjak rriten dhe shfaqet hiperglicemia.



Me kalimin e kohës, nëse nivelet e sheqerit në gjak mbeten të larta, mund të vërehen dëmtime në sy, zemër, veshka, nerva, tru dhe këmbë (ndërlikime të diabetit).

Llojet e diabetit



Diabeti melit i Tipit 1 (DMT1), që shfaqet veçanërisht në moshë të reja, karakterizohet nga mungesa e sekretimit të insulinës dhe mund të trajtohet vetëm me administrimin e saj nga jashtë.



Diabeti melit i Tipit 2 (DMT2), i cili është shpesh i ndërlidhur me mbipeshën/obezitetin, është forma më e përhapur e diabetit dhe është zakonisht i trashëguar. Diabeti i Tipit 2 shkaktohet nga marrja e disa ilaçeve (kortizon, etj.) dhe/ose nga endokrinopati apo nga sëmundje të pankreasit.



Diabeti gestacional (DMG) shfaqet gjatë shtatzënisë dhe e vë gruan shtatzënë në rrezik më të madh për zhvillimin e DMT2.

Simptomat



Disa nga simptomat karakteristike të niveleve të larta të sheqerit në gjak, për të cilat është e rëndësishme të kontaktohet mjeku dhe të kontrollohet glicemia, janë: ndjesi e shtuar etjeje, nevojë e shpeshtë për të urinuar, lodhje, humbje peshe, infeksione urinare, të lëkurës ose të dhëmbëve, të vështira për t'u kuruar.

Diagnoza



Diabeti diagnostikohet me anë të dy vlerave të sheqerit në gjak: glicemi esëll > ose = 126 mg/dl, glicemi > 200 mg/dl në çdo moment të ditës ose me anë të dy leximeve të veçanta të HbA1C > 6.5% (48 mmol/L).

Terapia



Diabeti mbahet nën kontroll duke kryer aktivitet të rregullt fizik, duke ndjekur një dietë të ekuilibruar, duke humbur peshën e tepërt e nëse është e nevojshme, duke përdorur ilaçe hipoglicemizuese nga goja apo me injektim ose duke marrë insulinë.